



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:021498

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05654926

KF.nr.484/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli dhe me procesmbajtëse Arlinda Hyseni, në kontestin tregtar administrativ të paditësit “Spitali Sirona Hospital” Sh.P.K., me seli në Graçanicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson H.L. jurist i diplomuar, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e Aktvendimit, me objekt kontesti kundërvajtje doganore, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik, të mbajtur me datë 29.04.2024, në prani të autorizuarit të palës paditëse H.L., dhe të autorizuarit të palës së paditur Blerta Gagica, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Spitali Sirona Hospital” Sh.P.K me seli në Graçanicë, në tërësi si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr.01.3.2.2/322/2018 i datës 22.01.2021, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi ka parashtruar padi në gjykatë, me datë 04.02.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke kërkuar anulimin e Aktvendimit nr.01.3.2.2/322/2018 i datës 22.01.2021, të paditurës Dogana e Kosovës, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike. Përfaqësuesi i palës paditëse si në padi, në seancën

kryesore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: Aktgjykimi A.nr.2019/18 mbi anulimin e vendimit nr. 01.3.2.2/232 i datës 26.06.2018 ka qenë i drejtë sepse paditësi në asnjë veprim apo me asnjë qellim nuk ka pasur qëllim për shmangie nga taksa doganore në lartësi prej 128 euro dhe e ka respektuar me përpikëri dispozitat e nenit 276 të KDA-së. Ndërsa e paditura me asnjë provë apo fakt nuk ka arritur të vërtetojë se paditësi ka bërë kundërvajtje doganore dhe e njëjta edhe tani nuk ka prezantuar edhe një provë të re relevante që edhe gjykatës t'ia largoj dilemat apo paqartësitë e përmendura me përpara. Në këtë rast deklaroj si në vijmë : Paditësi apo “Spitali Sirona Hospital”, ka porositur mallin e importuar dhe me arritjen e mallit ka angazhuar shpediterin për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve procedurale dhe ligjore rreth zhdoganimit me që rast e njëjta nuk ka pasur rast as qasje për çfarë do ndërhyrje, çka nënkupton se nuk mban as përgjegjësi për çfarë do parregullsie eventuale që pretendohet ti mvishet. Malli është me origjinë nga Japonia dhe me traditë dhe standarde të larta ku nuk ka edhe mundësi teorike për çfarë do manipulimi të dokumentacionit dhe kodeve të përcaktuara ndërkombëtarisht dhe ato kodet si të tilla janë të vendosura nga ata duke mos dashur dhe të mos nënçmojnë ekspertizën e Doganës së Kosovës të cilët mendojnë se Kodi Tarifor 3822 është jo i duhuri për këtë produkt dhe i njëjti është dashur të zëvendësohet me Kodin 3821 dhe të paguaj taksën doganore për 10% më të lartë dhe e konsideroj si jo të drejtë për arsye se importuesi i një malli nuk ka kurrfarë autorizimi apo kompetencë të ndërhyjë në kodin apo tarifatat doganore në mënyrë arbitrare. Paditësi nuk ka bërë asnjë shkelje ngase në bazë të DUD-it në mënyrë korrekte dhe të saktë e ka deklaruar sasinë, cilësinë, llojin e produktit, kodin tarifor, vlerën dhe origjinën e produktit në baze të dokumentacionit përcjellës. Edhe nga pse u tha më lart kërkoj nga gjykata që të marr aktgjykim ashtu siç është specifikuar në padi. Shpenzimet e procedurës i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 25.11.2021, e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar. Aktvendimi është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme relevante juridike. Përfaqësuesi i palës së paditur, në seancën kryesore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: Mbesim në tërësi pranë përgjigjes në padi si dhe mbesim në tërësi pranë sqarimeve dhe elaborimeve si në arsyetimin e nxjerre të vendimit nga Dogana e Kosovës duke theksuar se Sektori për Kundërvajtje ka vepruar drejtë kur paditësin e ka shpallur përgjegjës për kundërvajtje doganore me të cilin i njëjti nuk e ka deklaruar saktë kodin tarifor e i cili kod sipas paditësit e liron mallin nga taksa doganore ndërsa sipas shënimeve të doganës konkretisht

vendimit mbi klasifikimin tarifor e obligon që të paguaj taksën doganore në bazë të kodit siç është përcaktuar në atë mendim. Andaj pretendimet e palës paditëse i kundërshtojmë duke theksuar se paditësi është dashur ti ndërmarr për t'ju shmangur nga përgjegjësia ligjore pasi që dispozitat nga neni 106 i UA 11/2009 i cili zbaton KDA është paraparë që paraqitja pranë një sektori apo pranë një zyre doganore e një deklarate e nënshkruar nga deklaruesi apo përfaqësuesi i tij, atë person sipas dispozitave ne fuqi e bënë përgjegjës për saktësinë e informacionit të paraqitur në deklarata, vërtetësinë e dokumenteve që i bashkëngjitet deklaratës dhe përmbajtjen e të gjitha obligimeve që lidhen me vendosjen e mallrave në procedure përkatëse. Andaj ne këtë kuptim Dogana i ka shqiptuar kundërvajtje doganore e cila i vihet ne barrë paditësit në bazë te paditësit. Bazuar në thëniet e cekura si më lart, i propozojmë gjykatës që të marr aktgjykim me të cilin refuzohet padia e paditësit si e pa bazuar dhe të lërë në fuqi vendimin kontestues. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 29.04.2024, ka administruar provat dhe atë: Pro-fatura nr.179, Aktvendimi nr.01.3.2.2/322/2018 i datës 22.01.2021, Përgjigje në padi e datës 25.11.2021, Aktvendimi nr.01.3.2.2/322 i datës 26.06.2018, Ankesa e ushtruar në Doganë, Procesi mbi kundërvajtjen doganore, Mendimi për klasifikim tarifor nr.79/22.05.2018, Kërkesa për tarifim të mallit e datës 21.05.2018, Aktvendimi 03.1.7-2018-778 i datës 23.05.2018, dhe Aktgjykimi A.nr.2019/18 i datës 04.11.2020.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, nga deklaratimet në padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se paditësi me anë të deklaratës unike doganore R-6164 ka deklaruar mallin “Reagenca Diagnosostikuese Kitazato Cryotop” të cilin mall e ka deklaruar me kodin doganor tarifor 3822 0000. Jo kontestuese mbesin edhe fakte se Sektori për

Kundërvajtje në Prishtinë me aktvendimi nr.03.1.7-2018-778 datë 23.05.2018 subjektit në procedurë i ka shqiptuar gjobën administrative në vlerë prej 500.00 €, i pa kënaqur me një vendim të tillë subjekti ankimor ka parashtrua kërkesë për rishqyrtimin e vendimit tek Drejtori Gjeneral, i cili i njëjti i ka refuzuar kërkesën si të pabazuar, subjekti ankimor i pakënaqur me vendimin ka parashtruar padi pran Gjykatës Themelore në Prishtinë, e cila me aktgjykim me A.nr.2019/2018 datë 04.11.2020 e ka aprovuar kërkesëpadinë si të bazuar, ka anuluar aktvendimin e atakuar si dhe lëndën ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje. Jo kontestuese mbetet edhe fakti se Dogana e Kosovës, ka sjell Aktvendimin nr.01.3.2.2/322/2018 i datës 22.01.2021, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektin në procedurë, për rishqyrtimin e aktvendimit nr. 03.1.7-2018-778 të datës 23.05.2018, e kundër të cilit akt, paditësi me datë 04.02.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ pran Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative Divizioni Fiskal.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura me aktvendimin kontestues e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit, për rishqyrtimin e Aktvendimit nr. 03.1.7-2018-778 të datës 23.05.2018. E paditura ka vlerësuar se sektori për kundërvajtje doganore ka vepruar drejtë kur subjektin ankimor e ka shpallur përgjegjës për kundërvajtje doganore, për shkak se në Zyrën Doganore Aeroport, nuk e ka deklaruar saktë kodin tarifor me anë të deklaratës R-6164 për mallin “Reagenca Diagnostifikuese Kitazato Cryotop”, të cilin mall e ka deklaruar me kodin tarifor 3822 0000, i cili kod e liron mallin nga taksa doganore 10%, ndërsa përshkrimi i duhur i mallit duhet të jetë “Mjedise të përgatitura për zhvillimin e kulturave të mikoroorganizimave-Kitazato Cryotop” dhe kod i duhur duhet të jetë 3821 0000 00 (mendimi tarifor: 04.1.2 nr. 79/22.05.2018) sipas të cilit kod duhet të paguaj taksën doganore 10%, ku me këtë veprim i është shmangur taksave doganore në vlerë prej 128.69 €, ku ka vepruar në këtë mënyrë me qëllim që të paguaj taksën doganore në kundërshtim me nenin 276 pika (k) të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. Nr.04/L-099, ku thuhet: *“Në qoftë se, në Deklaratën Unike Doganore në mënyrë të rrejshme, të pasaktë apo jo të plotë shënon sasinë, cilësinë, llojin, kodin tarifor, vlerën apo origjinën e mallit ose nuk e përfshin tërë mallin, që ka rezultuar me llogaritjen ose pagesën e borxhit doganor në shumë më të vogël nga ajo reale, do të gjobitet me gjobë në të holla në shumë prej pesëqindë (500.00) deri në dhjetëmijë (10,000.00) €.* Tutje ka theksuar se kërkesën e kontrollit pas importues shënimeve sqaruese të krerëve 3821 dhe 3822, Sektori i Tarifës mendon

se deklarimi në kreun 3822 për mallin kitazato Cryotop si reagente diagnostifikuese apo laboratorike nuk është i duhur, sepse kemi të bëjmë me produkte të kreut 3821 gjegjësisht kemi të bëjmë me Solucione verifikimi, tretjes shpërndarjes pra me mjedise të përgatitur për ruajtjen e kulturave e mikroorganizmave, andaj klasifikimi dhe përshkrimi i duhur është në kodin 3821000000 me përshkrim *“Mjedise të përgatitura për zhvillimin e kulturave të mikroorganizmave Kitazato Cryotop”*. Sektori i Tarifës ka konfirmuar se ky klasifikim bazohet në rregullat e përgjithshme numër 1-6 për interpretimin e TARIK-2017, në bazë të shënimeve shpjeguese të seksionit IV Kapitulli 38, shënimeve sqaruese të HS-të për kreun 3821 dhe 3822, informata tjera nga subjekti importues, përshkrimi në pro faturën e mallit 179 datë 09.05.2018, zhdoganimeve tjera për produktin identik si dhe informatave të tjera nga interneti në lidhje me produktin në kontest. Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative. Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata nuk ka mundur t’i merr për bazë pretendimet tjera të paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Pretendimin e paditësit se deklarimi i mallit është bërë në përputhshmëri të plot me ligj duke paraqitur para shërbimeve doganore dokumentacionin e kompletuar zyrtar me të gjitha të dhënat e nevojshme. Gjykata nuk e pranon si të drejtë për faktin se Dogana e Kosovës ka sqaruar se subjekti në procedurë është përgjegjës për deklarimin e mallit konform gjendjes faktike dhe të gjitha këto veprime subjekti duhet ti ndërmarr për tu shmangur nga përgjegjësia ligjore, pasi që dispozitat e nenit 106 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 i cili implementon Kodin Doganor dhe të Akcizave është paraparë që *“Paraqitja pran një zyre/sektori doganor të një deklarate të nënshkruar nga deklaruesi apo përfaqësuesi i tij, atë person, sipas dispozitave në fuqi e bënë përgjegjës për : saktësinë e informacionit të paraqitur në deklaratë, vërtetësinë e dokumentacionit që i bashkëngjitet deklaratës dhe përmbajtjen e të gjitha obligimeve që e lidhen me vendosjen e mallrave në procedurë përkatëse”*. Gjykata konstaton se ka qenë obligim i paditësit që në procedurë administrative tek e paditura por edhe para gjykatës të ofrojë prova konkrete për të vërtetuar gjendjen faktike, por gjithmonë para se Dogana të merr veprime për të

kontrolluar mallin, qoftë kontroll dokumentare qoftë fizike. Gjykata vlerëson se e paditura drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të këtij paditësit.

Neni 43, par 1. i LKA-së, “Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative”, andaj paditësi në këtë kontest tregtar administrative ka dështuar që të prezantojë provat, e me të cilën do të mbështeste pretendimet e tij si në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij, si dhe një përmbledhje të arsyetimit ligjor dhe faktik të padisë.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje tregtare administrative drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj thëniet e padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuara nga e paditura.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata komfor dispozitave ligjore të 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.484/22 datë 29.04.2024

Procesmbajtëse,
Arlinda HYSENI

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.